REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 33/17
Datë/Datum 08.03.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 33/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenit 28 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në përbërje **Ekrem Salihu–Kryetar, Nuhi Paçarizi-Anëtar** dhe **Goran Milenkovič- Anëtar,** duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 33/17, të parashtruar nga operatori ekonomik **"Pharmachem-Dega Kosovë"** me seli Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me Pajisje Laboratorike dhe Pajisje të tjera për nevojat e UP-së"- Lot 4,** me nr. të prokurimit: 90400/16/022/111, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" , në seancën e dt. 02 mars 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **HEDHET ,** si e palejuar ankesa e OE **"Pharmachem-Dega Kosovë"** me seli ne Prishtinë, me nr. të protokollit 33/17, kundër vendimit të autoritetit kontraktues Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", për aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me Pajisje Laboratorike dhe Pajisje të tjera për nevojat e UP-së"- Lot 4,** me nr. të prokurimit: 90400/16/022/111, për shkak se i njëjti nuk ka mund të dëshmoj interes juridik material konfrom nenit 111 par. 1 pika 1.5 dhe 1.8 të LPP-së, pasi i njëjti është i papërgjegjshëm.

I. **Vërtetohet**, vendimi i autoritetit kontraktues Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", njoftim për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me Pajisje Laboratorike dhe Pajisje të tjera për nevojat e UP-së"- Lot 4,** me nr. të prokurimit: 90400/16/022/111, si i bazuar.

II. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .

III. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

IV. Operatorit ekonomik ankues "Pharmachem-Dega Kosovë" me seli në Prishtinë, konform nenit 118 pika 3, i kthehen tarifa e sigurimit të ankesës.

V. Urdhërohen, OE ankues që konform nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues– Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", më dt. 29 shtator 2016, ka publikuar *Njoftim për kontratë* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me Pajisje Laboratorike dhe Pajisje të tjera për nevojat e UP-së"- Lot 4,** me nr. të prokurimit: 90400/16/022/111.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar 2 (dy) operator ekonomik, ku sipas komisionit vlerësues pranë autoritet kontraktues, 1 (një) operator ekonomik i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit, ndërsa 1 (një) operator ekonomik është i pa përgjegjshëm për arsye se nuk ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Autoriteti kontraktues më 17 janar 2017, ka publikuar njoftimi për dhënie të kontratës.

Kundër vendimit për refuzimi të kërkesës për rishqyrtim të dt. 26 janar 2017, operatori ekonomik **"Pharmachem-Dega Kosovë"** me seli Prishtinë, në afatin e paparë ligjor ka parashtruar ankesë në OSHP-ë.

Pikat e ankesës:

Pala ankuese pretendon se autoriteti kontraktues Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje te nenit 7 paragrafi 1,2 dhe 6 , nenit 59 paragrafi 4 dhe nenit 115 të LPP-së,

Ankesa e operatorit ekonomik është e afatëshme dhe është parashtruar nga ana e personit kompetent.

Ankesa është e pa bazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën 02 shkurt 2017, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe eksperten teknike për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues/teknike, me datën 13 shkurt 2017, i dorëzon panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku në raport lidhur me pretendimet ankimore të OE "Pharmachem" për pozicionet ose artikujt nr. 18, 24, 37, 43, 45 dhe 46, sqaron se nuk qëndrojnë, pasi që OE "LEDI-MED", e posedon katalogun me përshkrime për secilin pozicion. Operatori ekonomik "Ledi-Med" sh.p.k. te pozicioni nr. 18 , ka ofrua peshoren matëse me specifikacion sipas kërkesës 800/5500G X 0,01/0,1G, që do të thotë se është brenda diapazonit të matjes 800-5500 gram, që do të thotë se kjo matë peshën 1000-5000, si dhe ka precizitetin 0.01/0.1 g, ndërsa OE "Pharmachem" prezanton peshoren e tipit ËLC6/A2 RADËAG ku është ne data sheet tregon vetëm kapacitetin e matjes max 6 kg ose 6000g, e jo edhe minimumin e saj siç janë kërkuar në pozicionin 9.1 pika 9.2 të FDT-së, dhe nuk e plotëson këtë kriter për produktin e ofruar me tilla karakteristika.

Duke u bazuar në pretendimet ankimore të OE: "PHARAMACHEM" për pozicioni nr. 24 "Flat jacks" pajisje për kontrollin e rezistencës dhe E-modulit për muratura me metoda të pllakave shtypëse, ekspertja teknike sqaron se OE "LEDI-MED" i plotëson kriteret sipas FDT-së pozicioni 9.1 pika 9.2 te dëshmitë e kërkuar dokumentare pika 2. Specifikacionet teknike të detyrueshme.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE: "PHARAMACHEM" se OE "LEDI-MED" nuk ka ofrua artikullin Nr. 37 me specifikacion të kërkuar nga AK-UP si set (komplet) nga katalogu shihet shumë e qartë pajisja matëse OEDOMETER e kompletuar me aksesorë.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE "PHARAMACHEM" se OE "LEDI-MED" ka ofrua artikullin Nr. 43 tipit i cili nuk prodhohet nga "Lange HACH" , ekspertja teknik sqaron se është e pa bazë sepse nuk ka asnjë argument, e-mail ose konfirmimim nga OE "PHARMACHEM" prej "Lange HACH" për të na bind se nuk prodhohet një tip i tillë, ndërsa nga autoriteti kontraktues është kërkua në dosje "Spektri me gjatësi valore 340-900nm", të cilin e ka ofertua edhe i rekomanduari për shpërblim me kontratë OE "LEDI-MED" sh.p.k. Pajisja matëse ose spektrophotometri i ofruar nga operatori i rekomanduar me kontratë i plotëson kriteret që janë kërkuar në specifikimet teknike.

Ekspertja teknike gjithashtu në raportin e ekspertizës ka sqaruar se OE: "Pharmachem" nuk i plotëson kriteret sipas FDT-së.

Sa përket pozicionit nr. 45, si pretendim ankimor i OE: "PHARAMACHEM", se nuk e ka cek se cilin tip e oferton, ekspertja teknike sqaron nga katalogu që ka prezantua OE "LEDI-MED" sh.p.k shihet se ka rrumbullakosu modelin e tipit LT 200-2 thermoreactor ose thermostat me dy blloqe COD DHE TOC, ku me të njëjtin tip termostatit ka ofertua edhe OE ankues "Pharmachem".

Po ashtu, pozicioni nr. 46, si pretendim ankimor i fundit nga OE "PHARMACHEM" nuk qëndron, sepse OE "LEDI-MED" ka të prezantuar katalogun si dhe ka të nënvizuar me ngjyre të verdhë pajisjen matëse tipit sensION+MM150 Portable Multi Meter Kit me të gjithë aksesoret e kërkuar sipas FDT nga AK.

Bazuar në atë që u tha më lartë, ekspertja shqyrtues/ teknike i rekomandon panelit shqyrtues që të refuzohet si e pa bazuar ankesën e operatorit ekonomik ankues, ndërsa të aprovoj vendimin e autoritetit kontraktues njoftim për dhëniet të kontratës, të dt. 17 janar 2017.

Autoriteti kontraktues Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", përmes parashtresë me shkrim të dt. 15 shkurt 2017, e njofton panelin shqyrtues se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues/teknik të dhënë na raportin e ekspertizës së dt. 13 shkurt 2017.

Operatori ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të dt. 16 shkurt 2017, e njofton panelin shqyrtues se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues/teknik të dhënë na raportin e ekspertizës së dt. 13 shkurt 2017.

Me rastin e procedurës para këtij organi u prezantuan provat duke e bërë kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet: nga autorizimi i këtij aktivitetit, njoftimit për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i rivlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik ankues, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik i dt. 13 shkurt 2017, si dhe parashtresën e autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues mbi raportin e ekspertit shqyrtues/teknik.

Eksperti shqyrtues i prokurimit z. Guri, deklaroj: pretendimet e operatorit ekonomik ankues kanë qenë në përgjithësi për specifikime teknike të cilat janë shqyrtuar nga ekspertja teknike.

Ekspertja teknike znj. Spahiu, deklaroj: pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues **"Pharmachem"**, ndaj operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë "LEDI MED", nuk qëndrojnë pasi që OE "LEDI MED" ka plotësuar të gjitha specifikat teknike të cekura në dosjen e tenderit dhe këto i kam dhënë ne detaje sqarime ne raportin e ekspertizës. Ndërsa, operatori ekonomik ankues "Pharmachem" është i pa përgjegjshëm, pasi i njëjti nuk ka plotësuar kërkesat e dy artikujve tek pozicioni nr. 43 lidhur me kërkesat e autoritetit kontraktues për pajiset e kërkuara dhe për këtë po ashtu kam dhënë sqarim në detaj në raportin dt. 13 shkurt 2017

Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankues se gjoja produkti-modeli tek pozicioni nr. 43, se i njëjti nuk prodhohet, ky pretendim nuk qëndron sepse në cilësinë e ekspertes teknike iu kam drejtuar prodhuesit "Hach" dhe i njëjti prodhues me dt. 13 shkurt 2017, ka kthyer konfirmimin me të cilin dëshmon se ai benë prodhimin e produktit-modelit DR2800 i cili mund të zëvendësohet me DR3900, kurse ankuesi ka ofertuar me produktin-modelin DR1900, gjë që është ne kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit.

Ne fund të prezantimit ekspertja teknike shtoi e qëndroj pranë raportit të ekspertizës, të datës 13 shkurt 2017".

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje te nenit 7 dhe 59 të LPP-së, paneli shqyrtues bazuar ne të gjeturat e eksperti shqyrtues/teknik, vlerëson se nuk qëndrojnë për faktin se autoriteti kontraktues gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ju ka përmbajtur kritereve të përzgjedhjes të specifikuar në FTD, ngase operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka plotësuar specifikimin teknik ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit, gjë të cilën e ka konstatuar edhe ekspertja teknike në sqarimet e dhëna në raportin e ekspertizës së dt. 13 shkurt 2017.

Paneli shqyrtues bazuar ne nenin 56 paragrafi 1 pika 1.1 dhe 1.2 të LPP-së, sqaron se autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit si dhe specifikimin teknike, ndërsa operatori ekonomik ankues nuk ka plotësuar specifikimin teknike ashtu siç është kërkuara në Aneksin 1. Specifikimet teknike, të dosjes së tenderit.Ankuesi nuk ka mundur të dëshmoj interes juridiko-material konform nenit 111.par.piks1.5 dhe 1.8 t LPP-së, sepse i njejti në asnjë rrethanë nuk mund të jet fitues i këtij tenderi ngase është i pa përgjegjëshëm.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes se tenderit, konstatimeve të cekura në ekspertizën e ekspertes shqyrtues/teknike, shqyrtimit të pikave pretenduese të operatorit ekonomik ankues, parashtresës së operatorit ekonomik ankues, parashtresës së autoritetit kontraktues, sqarimeve të dhëna nga ekspertit shqyrtues/teknik gjatë seancës dëgjimore, ku ndër të tjera deklaroj: "për *produktin nr. 43 ankuesi ka ofertuar me produktin-modelin DR1900, që është ne kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit* ", konstatoj se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me Pajisje Laboratorike dhe Pajisje të tjera për nevojat e UP-së"- Lot 4,** me nr. të prokurimit: 90400/16/022/111, ka respektuar dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart ia fali besimin raportit të ekspertëve shqyrtues të dt.13.02.2017 dhe konform nenit: 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

KSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet
Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative
për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Ekrem Salihu

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 ekzemplar – OE "Pharmachem-Dega Kosovë" Prishtinë
1x1 ekzemplar - AK- Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
1x1 ekzemplar – Arkivës së OSHP-së